

## NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës :  
**Specialist i Çështjeve të Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë**

**Procedura :** **PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se :

- **Z.Altin Shano** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.
- **Znj. Silvana Leka** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

### **Konkurimi:**

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **09.12.2020** ora **10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **09.12.2020** ora **13:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP**, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidateve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në **25 pikë**;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në **60 pike**;

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, nese kandidati grumbullon më shume se (mbi 30 pikë e lart), nga vlerësimi me shkrim ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit. Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist i Çështjeve të Integritit dhe Marrëdhënieve me Jashtë**.

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV të Vendimit nr. 243, date 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive"i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **09.12.2020**.

**Njoftimi do të publikohet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **15.12.2020**.

*Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)*